

NJOHJA ME KODIN E IESBA-së

Pjesa 5: Pavarësia



Në vijim të pajtueshmërisë me parimet themelore, Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë (SNP) kërkojnë që profesionistët kontabël (PK) në praktikën publike të jenë të pavarur kur kryejnë angazhimet e auditimit, rishikimit ose angazhimet e tjera të sigurisë. Pavarësia është e lidhur ngushtë me parimet e integritetit dhe objektivitetit dhe është një element i rëndësishëm i shërbimit në interes të publikut.

Këndvështrimi i Brendshëm:

Në pjesët e mëparshme të Njohjes me Kodin e IESBA-së, ne shqyrtuam parimet themelore të Kodit dhe kuadrin konceptual. Nga këndvështrimi i një PK në një kompani prodhuese ndërkombëtare që mundohet të zgjerohet në një treg të ri, ne:

- Rishikuar shembujt e fakteve dhe rrethanave që mund të krijojnë kërcënime të pajtueshmërisë me parimet themelore; dhe
- Shqyrtuam procesin e ndjekur për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar këto kërcënime, përfshirë mënyrën e zbatimit të masave mbrojtëse të përshtatshme.

Këndvështrimi i Jashtëm:

Le ta ndryshojmë këndvështrimin dhe të konsiderojmë sesi ndikon situata tek audituesit e kompanisë. Kujtojmë që:

- Ka komunikime me email të cilat tregojnë se transfertat e mjeteve monetare janë bërë nga kompania në llogaritë bankare të jashtme gjatë së njëjtës kohë që po hartohet plani për zgjerim.
- Gjatë auditimit, disa transfertat të mëdha bankare u evidentuan nga software-i i përdorur nga audituesi për analizimin e të dhënave.
- Audituesi në terren ka dërguar transaksionet e evidentuara te menaxheri i auditimit për rishikim.

Pse pavarësia është kaq e rëndësishme?


Palët e interesuara duhet të besojnë se audituesit janë të pavarur nga klienti i tyre dhe nga drejtimi. Audituesit pritët:

- Të lerësojnë përshtatshmërinë e evidencës;
- Të ndjekin çdo mospërputhje;
- Të sfidojnë ekipin drejtues të një klienti –deri duke përfshirë CEO-n; dhe
- Të ndërmarrin veprime të përshtatshme nëse dyshojnë për mashtrim.

Për t'u mbështetur në raportin e audituesit, duhet të ketë besueshmëri që gjykimi profesional i audituesit nuk është komprometuar dhe se audituesi nuk është ndikuar në atë mënyrë që të kërcënojë integritetin, objektivitetin, ose skepticitizmin e tij profesional.

PAVARËSIA KUNDREJT PARIMEVE THEMELORE

Pavarësia nuk është një parim themelor, por të njëjtat kërcënime të pajtueshmërisë me parimet themelore gjithashtu mund të kërcënojnë pavarësinë. Në një auditim të pasqyrave financiare, pajtueshmëria me parimet mbështet ushtrimin e skepticizmit profesional.



ZBATIMI I KUADRIT KONCEPTUAL TE PAVARËSIA

Identifikimi i Kërcënimeve të Pavarësisë

Konsideroni ndikimin në besimin e palëve të interesuara nëse audituesi i një kompanie prodhuese identifikon kërcënime të mëposhtme:

- **Vetë-rishikimi** - grupi këshillimor i firmës audituese ofroi fillimisht konsulentë në planet e zgjerimit të kompanisë dhe vlerësimin e rrezikut.
- **Favorizimi** - firma e auditimit do të angazhohet për të ndihmuar në mbrojtjen e veprimeve të kompanisë në gjykatë, nëse është e nevojshme, në të ardhmen.
- **Frikësimi** - kompania është një klient shumë i rëndësishëm për firmën audituese dhe CEO kërcënon ta pushojë firmën nëse ata kërkojnë kohë shtesë për të shqyrtuar transaksionet jashtë vendit.

Është e qartë që secili prej këtyre kërcënimeve ka mundësi të ulë besimin e palëve të interesuara në raportin e audituesit. Nëse këto kërcënime shfaqen, ka të ngjarë që të mos jenë në një nivel të pranueshëm dhe do të jetë e nevojshme të adresohen.

Pavarësia kërkon që audituesi të japë mendimin e tij të lirë dhe i pa influencuar, por pavarësia e mendjes nuk është e mjaftueshme. Audituesi gjithashtu duhet të shihet si i pavarur nga një vëzhgues i paanshëm. Testi i palëve të treta të arsyeshme dhe të besueshme aplikohet për të përcaktuar nëse audituesi ka pavarësi në dukje.

Vlerësimi dhe Adresimi i Kërcënimeve të Pavarësisë

Secili prej kërcënimeve të identifikuar ndaj pavarësisë duhet të vlerësohet dhe nëse supozohet të jetë në një nivel të papranueshëm, duhet të adresohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kuadrin konceptual (shiko pjesën 4).

Niveli i një kërcënimi ndaj pavarësisë do të ndikohet nga llojet e kushteve, politikave dhe procedurave që një firmë ka për të mbështetur sjelljen etike, si edhe çdo kërkesë rregullore. Këto janë të ndryshme nga masat mbrojtëse, të cilat janë veprime specifike që ndërmerr kompania për të reduktuar një kërcënim të identifikuar në një nivel të pranueshëm. Një formë e përdorur zakonisht e masave mbrojtëse është të paturit e një rishikimi të punës së firmës nga një rishikues i përshtatshëm - shpesh një PK tjetër - i cili është i informuar dhe i paanshëm.

Në disa situata, nuk ka masa mbrojtëse që mund të zvogëlojnë kërcënimet në një nivel të pranueshëm. Për shembull, IIS ndalon audituesit që të kenë një interes financiar në auditimin e një klienti.



Në vijim të dispozitave që ndihmojnë firmat të zbatojnë kuadrin konceptual ndaj pavarësisë, IIS merret me tema të tjera specifike, duke përfshirë komunikimet e kërkuara me personat e ngarkuar me qeverisjen, kërkesat e pavarësisë nga firmat e rrjetit dhe dispozitat që zbatohen kur firma identifikon një shkelje të pavarësisë.

KU MUND TË GJENDET INFORMACIONI I NEVOJSHËM?



Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë janë të përfshira në Pjesët **4A** për angazhimet e rishikimit dhe auditimit dhe **4B** për angazhimet e sigurisë të tjera nga angazhimet e auditimit dhe rishikimit.



ECode, i cili është i disponueshëm në www.IESBAeCode.org, është një burim online për profesionistët kontabël dhe përdoruesit e tjerë të Kodit. Ai siguron akses të shpejtë dhe eficient në Kod, duke bërë atë më të lehtë për tu përdorur, implementuar dhe zbatuar.

“Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 5: Pavarësia”, publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) në Prill 2020 në gjuhën angleze, është përkthyer në gjuhën shqipe nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) në Qershor 2020, dhe është riprodhuar me lejen e IFAC. Teksti i aprovuar i të gjitha publikimeve të IFAC është ai i publikuar nga IFAC në gjuhën angleze. IFAC nuk mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e përkthimit ose për veprimet që mund të rrjedhin prej tyre.

Teksti në gjuhën angleze “Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 5: Pavarësia” © 2020 nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Teksti në gjuhën shqipe “Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 5: Pavarësia” © [2020] nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Titulli origjinal: “Exploring the IESBA Code Installment 5 – Independence”

Kontakttoni Permissions@ifac.org për marrjen e lejes për të riprodhuar, ruajtur, shpërndarë, apo për përdorime të tjera të ngjashme të këtij dokumenti.